

**BESIM QERIQI**

Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Studimeve Kroatë

Departamenti i Historisë

besimqeriqi1@gmail.com

**GAZIMESTANI, LINDJA E NJË MITI****Abstrakt:**

*Për shekuj me radhë, historiografia serbe e ka mitizuar 28 qershorin si një ngjarje në të cilën është përcaktuar fati serb. Për nga intensiteti nuk krahasohet me asnjë datë tjetër, gjatë gjithë vitit, me të simbolizohet vdekja, ringjallja, guximi, hidhërimi, e shpresa, e mbi të gjitha hakmarrja.*

*Përmes këtij punimi synojmë të tregojmë se si një popull i tërë u përfshi në një kauzë mashtruese nacionaliste serbe që si pikënisje kishte festimin e Betejës së Kosovës, por që në esencë mbrapa saj qëndronte ideja serbomadhe. Ideja se serbët janë kontribuesit më të mëdhenj, janë mbrojtësit e këtyre trevave. Të tjerët: kroatët, shqiptarët, sllovenët, boshnjakët ose duhet të nënshtrohen ose do të përballen me luftë.*

*Metodologjia përfshin metodën kualitative, përmes së cilës janë trajtuar raste studimore objektive me qëllim grumbullimin e informacioneve të hollësishme. E kombinuar në mënyrë të veçantë me metodën krahasuese, ku po ashtu janë analizuar e krahasuar shkrime, e intervista të kohës.*

*Konkluzionet - ngjarjet që ndodhën më pas vërtetuan faktin se: sllovenët, kroatët, boshnjakët dhe së fundmi shqiptarët, në momentin që nuk pranuan nënshtrimin serb u përballën me luftëra të njëpasnjëshme. Pasojat e këtyre luftërave tashmë janë të njohura, sikurse dihet shkaktari kryesor dhe i vetëm, politika nacionaliste serbe me në krye liderin e saj Slobodan Milošević.*

**Fjalë kyçe:**

Gazimestani, miti, Slobodan Milošević, kisha serbe, hakmarrja, festimi, nënshtrimi, kërcënimi.

## Hyrje

Qarqet nacionaliste serbe asnjëherë nuk ishin pajtuar me Kushtetutën e vitit 1974, e cila Kosovës dhe Vojvodinës u siguronte autonomi vetëqeverisëse. Asokohe zërat e tillë kishin mbetur të izoluar [të paktën për një kohë - B.Q.] si rezultat i një reforme, kompromisi të gjithmbarshëm jugosllav.<sup>1</sup> Kjo heshtje u thye pas vdekjes së liderit komunist Tito. Beogradi zyrtar menjëherë filloi në gjetjen e arsyeve për të vepruar në Kosovë. Si shkas arriti t'i përdorë demonstratat e rinisë kosovare të vitit 1981. Që atëherë e deri më 23 mars 1989, kur përfundimisht rrënohet autonomia e Kosovës, në tryezën e çdo qeverie serbe ka ekzistuar projekti për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Kur të gjitha procedurat ishin gati, momenti final i votimit siç pritej kishte kaluar me plot tension, e parregullsi. Paraprakisht kishte ndodhur një shtetrrëhim i plotë: i gjithë Parlamenti ishte i rrethuar me tanke, autobllinda, helikopterë, polici speciale; ushtria jugosllave kishte përqendruar mbi 15 000 mijë ushtarë, pjesëtarë të Sigurimit shtetëror ishin prezent kudo, funksionarë të lartë partiakë serbë po ashtu. Mbi deputetët shqiptarë drejtoheshin projektorë të fuqishëm televiziv për të parë se kush do të guxonte të kundërvihet. Ishte një situatë që njohësit e rrethanave në Ballkan e kanë krahasuar me miratimin e ligjit autorizues, me të cilin Adolf Hitler kishte marrë pushtetin absolut në vitin 1933.<sup>2</sup> Fitorja e dhunshme në Kosovë bëri që serbët dhe udhëheqja e tyre të përfshiheshin në një valë të vërtetë ngazëllimi.<sup>3</sup> Këtë entuziazëm më së miri e përshkruan fjalimi i Borisav Jović-it, në ditën e inaugurimit të

<sup>1</sup> Ivan Miladinović, "Uzaludne poruke Dobrice Ćosića: Početak procesa osamostaljenja Kosova i Metohije", *Novosti*, Beograd, 06.08. 2020 (shikuar më 28.10.2022). <https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/drustvo/aktuelno.290.html:869141-Uzaludne-poruke-Dobrice-Cosica-Pocetak-procesa-osamostaljenja-Kosova-i-Metohije>.

<sup>2</sup> Rreth kësaj pikëpamjeje lexo: Laura Sibler, Alan Little, *The Death of Yugoslavia* (Boston: Penguin Books, 1997), 68-9; Julie A. Mertus, *Kosovo How Myths and Truths Started a War* (Berkeley / Los Angeles / London: University of California Press, 1999), 182; Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo* (London: Pluto Press, 2000), 52; Neol Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër* (Prishtinë - Tiranë: Koha - Shtëpia e Librit, 2001), 358-9; Woflgan Petritsch & Robert Pichler, *Rruga e gjatë në Luftë - Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare 1989-1999*, përkthyer nga Genc Llafe (Prishtinë: KOHA, 2002), 52; Oliver Jens Schmitt, *Kosova Histori e një treve qendrore ballkanike* (Prishtinë: Koha, 2012), 252.

<sup>3</sup> Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë - Goditja në Kosovë* (Lubjanë: Lina, 2006), 144.

Kushtetutës Serbe, më 28 mars 1989. “Dita e sotme nuk është vetëm ditë solemne dhe hareje por edhe datë e madhe dhe e rëndësishme e historisë sonë kushtetuese e politike, datë që shënon mbarimin e një lufte të gjatë dhe të vështirë për barabarësi.”<sup>4</sup> Paradoksi i gjithë këtij diskursi nënkuptonte, se barabarësia ka pronësi dhe se ajo pronësi u takon vetëm serbëve, të tjerët ose duhet të nënshtrohen ose do të përballen me Serbinë. Ngjarjet që ndodhën më pas vërtetuan faktin se: sllovenët, kroatët, boshnjakët dhe së fundmi shqiptarët, në momentin që nuk pranuan nënshtrimin serb u përballën me luftëra të njëpasnjëshme. Pasojat e këtyre luftërave tashmë janë të njohura, sikurse dihet shkaktari kryesor dhe i vetëm, politika nacionaliste serbe me në krye liderin e saj Slobodan Milošević.

### **Të gjithë në shërbim të nacionalizmit serb**

Entuziazmi se me Kushtetutën e re ishte arritur unifikimi i Serbisë, nuk kishte të ndalur. Këto festime përkonin me një aktivitet jo të zakonshëm. Ishte viti jubilar i gjashtëqind vjetorit të Betejës së Kosovës. Politika serbe dëshironte ta kremtonte këtë ngjarje në mënyrë krejtësisht të veçantë si asnjëherë më parë. Së këtejmi, nga qershori i vitit 1988 kishte filluar numërimi mbrapsht i përvjetorit të Betejës së Kosovës.<sup>5</sup> Kisha ortodokse përveçse luajti rol kyç në organizimin e përvjetorit, qysh nga ardhja në pushtet e Milošević-it i dha përkrahje frymëzuese nacionalizmit serb. Kisha u ishte bashkuar historianëve e romancierëve që ushqenin urrejtje etnike, ku i veçonte shqiptarët si "përdhunues".<sup>6</sup> Kjo qasje vërtetohet sepse menjëherë pas betejës kishin filluar të shkruheshin tekste me motive kishtarë e që janë të lidhura me eposin e Kosovës, në përkujtim të heronjve të Betejës së Kosovës. Ato u fuqizuan në fund të shek. XIX me idenë që gjaku i kuq do të përsëritej deri në “hakmarrjen e Kosovës” dhe çlirimin e saj të plotë nga zgjedha turke.<sup>7</sup> Po në këtë kohë u bënë “përpjekje ideologjike”, që të synohej formimi i kombit serb. Shteti

<sup>4</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 29.03.1989, 1.

<sup>5</sup> Robert Kaplan *Fantazma e Ballkanit një udhëtim nëpër histori* (Tiranë: Plejad, 2011), 76.

<sup>6</sup> Branimir Anzulović, *Serbia hyjnore nga Miti te gjenocidi* (Prishtinë: KOHA, 2017), 190-191.

<sup>7</sup> Olga Zirojević, "Kosovo in the Collective Memory", in *The Road to War in Serbia Trauma and Catharsis*, edited by Nebojša Popov (Budapest: Central European University Press, 2000), 200.

kombëtar pa Kosovën nuk mund të merrej me mend.<sup>8</sup> Duke qenë se lufta kryesore ishte bërë për Kosovën, nacionalistët serbë të dehur nga ngazëllimi thoshin se "do të kthehen përfundimisht në Kosovë".<sup>9</sup> Ky fakt arsyetohet më së miri me shpërthimin e dinamizmit kombëtar serb, që gjallëroi kureshtjen për luftë. "Hakmarrja e Kosovës" u bë slogani i ditës. Betimi për t'u hakmarrë për Kosovën është bërë "pika vertikale e historisë serbe, sepse serbët nuk kanë harruar se ata u dëbuan nga një tokë që ishte depoja e të gjitha gjërave më të çmuara që ata kanë krijuar në historinë e tyre"; çlirimi i Kosovës në vitet 1912-1913 nënkuptonte një "kthim në atdheun e tyre të marrë me dhunë".<sup>10</sup> Ndër synimet e luftës serbo-malazeze në luftën e vitit 1912, prioritet ishte ripushtimi dhe çlirimi i Kosovës. Si rezultat, fushata pati një luftë të shenjtë.<sup>11</sup> Për ta rimarrë Kosovën, siç e hasim në literaturë "Serbinë e Vjetër", paraushtarakët serbë shndërruan fshatra të tëra shqiptare "në shtylla zjarri, banesat, pasuritë e grumbulluara nga baballarët dhe gjyshërit po digjeshin, fotografia u përsërit e gjitha rrugës për në Shkup. Atje serbët hynë në shtëpitë turke dhe shqiptare duke kryer të njëjtën detyrë në çdo rast: plaçkitje dhe vrasje... banorët janë zgjuar me pamjen e grumbujve të kufomave shqiptare me koka të prera".<sup>12</sup> Kjo frymë vrasëse krejtësisht transparente ishte futur thellë në ideologjinë serbe. Për Kosovën duhet të hakmerremi, - thoshte ideologu i Serbisë së Madhe, Jovan Cvijić, - duke dëbuar osmanët për të rivendosur traditat e vjetra. Në realizim të këtij synimi, Cvijić-i shkruante se ky borxh i shenjtë do të shlyhet në vitin 1912 kur Kosova u çlirua, nga pushtimi osman [u kolonizua nga ai serb - B.Q.]: "çdo fshatar serb donte ta shihte këtë faltore kombëtare dhe të merrte prej saj një copë tokë për kujtim".<sup>13</sup> Entuziazmi i ushtrisë serbe nuk përshkruhet. Ata këndojnë. Muzika dhe boritë luajnë: "Ne jemi të

<sup>8</sup> Wolfgang Höpken, "Legjenda e Ilahtarshme e Fushë-Kosovës", *Koha Ditore*, Prishtinë, 16 mars 1998, 6.

<sup>9</sup> Meier, *Fundi i Jugosllavisë*, 146.

<sup>10</sup> Sonja Biserko, *Yugoslavia's Implosion: The Fatal Attraction of Serbian Nationalism* (Beograd: The Norwegian Helsinki Committee, 2012), 193.

<sup>11</sup> Dimitrije Đorđević, "The Role of ST. Viturs Day in Modern Serbian," published by the *North American Society for Serbian Studies*, vol. 5, no. 3 (Beograd: 1990), 38.

<sup>12</sup> Jasminka Udovički, "Kosovo", in *Burne this House The Making and Unmaking of Yugoslavia*, by Jasminka Udovički & James Ridgeway (Durham - London: Duke University Press, 2000), 317.

<sup>13</sup> Branko Harvat, *Kosovsko Pitanje*, Vol. Drugo dopunjeno izdanje (Zagreb: Globus 1989), 23.

gjithë të rrëmbyer nga fitorja e madhe. Fitorja serbe në Kosovë garanton çlirimin tonë të plotë. Nuk ka forcë që do të mund t'i shtyjë serbët nga Kosova".<sup>14</sup> Këtë fakt e arsyeton edhe Bato Tomašević, i cili kujton një rrëfim familjar se si rreth gjashtëdhjetë mijë serbë dhe malazezë, midis të cilëve dhe prindërit e tij, iu përgjigjën thirrjeve patriotike nga Beogradi për ta "ripushtuar" Kosovën.<sup>15</sup> Poezia serbe nuk thotë asgjë mbi shqiptarët. Serbët u përkulën ta puthin tokën e shenjtë të Kosovës në vitin 1912, por kur u ngritën, përsëri panë se Kosova e pastruar prej turqve të saj nuk qe aspak një tokë e boshatisur. Shqiptarët gjithmonë kishin qenë aty, madje edhe në ditët e fuqisë e lavdisë serbe.<sup>16</sup> Ky fakt u bë shqetësimi kryesor i çdo qeverie serbe, i çdo intelektualit serb. Prej tyre kërkohet të veprohet, të ndërmerreshin hapa konkretë për ndryshimin e strukturës së popullsisë, sa nuk ishte bërë vonë. Zëri më kritik u bë njëri nga ideologët nacionalistë serbë, Vasa Čubrilović. Ai kritikonte institucionet qeveritare për mospërdorim të mjaftueshëm të forcës për shpërnguljen e shqiptarëve, duke e vlerësuar si "gabim themelor të autoriteteve", për të zgjidhur problemet e "Ballkanit që rridhte gjak" me anën e metodave perëndimore. Së këtejmi, si propozim ai sugjeronte që të shfrytëzoheshin divergjencat ndërkombëtare që ekzistonin në Europë e më gjerë, për të cilën theksonte: "Opinionin botëror do të shqetësohet pak." Megjithatë bota është mësuar me gjëra edhe më të këqija, sa që ky fakt nuk do të jetë shkak për shqetësim. Për ta balancuar këtë çështje Čubrilović-i, merrte shembuj nga shtetet e tjera, p.sh.: "Kur Gjermania po shpërngul dhjetëra mijëra çifutë dhe Rusia po kalon miliona njerëz nga një kontinent në tjetrin, shpërngulja e disa qindra mijëra shqiptarëve nuk do të çojë në shpërthimin e një lufte botërore."<sup>17</sup> Të gjitha këto plane bëheshin thuajse në mënyrë transparente, siç thotë Valere Gagnon, serbët historikisht kanë tentuar që problemin e Kosovës ta zgjidhin përmes dëbimit të shqiptarëve nga Kosova. Përveç Vaso Čubrilović-it, si hartues të planeve për shpërngulje ishin edhe shumë intelektualë të tjerë serbë,

<sup>14</sup> Momčilo Pavlović, "Kosovo Under Autonomy, 1974-1990" (2006 MM) (shikuar më 18.09.2022).

<https://cla.purdue.edu/academic/history/research/si/Team1Reporte.pdf>.

<sup>15</sup> Bato Tomašević, *Jetë dhe vdekje në Ballkan: një sagë familjare në një shekull konfliktesh* (Tiranë: Onufri, 2009), 18.

<sup>16</sup> Brian Hall, "Njerëzit që s'kanë nga t'ia mbajnë", në *Zëri* - E përjavshme politike, Prishtinë, 31 dhjetor 1994)

<sup>17</sup> Vaso Čubrilović, *Shpërngulja e shqiptarëve* (USA: Zëri i Kosovës, 1982), 18-19.

përfshi këtu Ivo Andrić (fitues i çmimit Nobel për letërsi 1961), dhe autorë të tjerë. Fatmirësisht këto plane, përkundër numrit të madh që arritën t'i shpërngulnin, nuk arritën të realizohen në tërësi. Arsyet mund të jenë të shumta, por dy konsiderohen si kryesore: *e para*, shpërthimi i Dy Luftërave Botërore, që për shqiptarët ishin një lloj fati në fatkeqësi; dhe *e dyta*, përkundër numrit të madh të të shpërngulurve, shqiptarët falë natalitetit të lartë arritën të mbesin si popullsia absolute e Kosovës me mbi 90%.<sup>18</sup>

### Malli për betejën e humbur

Edhe pse janë të rralla rastet në botë kur humbja e një beteje merr karakterin e një ngjarjeje pelegrinazhi e ditë festive, për serbët, në historiografinë e saj 28 qershori paraqet një emocion, krejtësisht të veçantë që për nga intensiteti nuk krahasohet me asnjë datë tjetër,<sup>19</sup> gjatë gjithë vitit, me të simbolizohet vdekja, ringjallja, guximi,\* hidhërimi,\*\* e shpresa.\*\*\* Megjithëse historia serbe njih edhe shumë disfata tjera, Beteja e Kosovës mbetet episodi më i popullarizuar, e 'i gdhendur thellë në vetëdijen e tyre kombëtare.<sup>20</sup> "Madhështia" dhe "tragjikja" e historisë serbe kodohen në këtë datë. Bëhen vazhdimisht përpjekje për gjoja orët vendimtare të historisë, që të vihen efektshëm në skenë. Përkundër fakteve që flasin për një realitet tjetër, si gjithmonë, rastet e miteve janë të njëjta. Kur bëhet fjalë për serbët, miti mbi Kosovën shumëfishohet e ekzagjerohet me dhjetëra herë.<sup>21</sup> Sidoqoftë, epika popullore serbe ndërtoi elemente të mitit me rastin e vdekjes së princit që në historiografinë serbe është quajtur si "Përbetimi i Kosovës", sipas të cilit Lazarit i kishte

<sup>18</sup> Valere Gagnon, "Shqiptarët nuk kanë asnjë interes të jenë me Serbinë", *Kombi*, Prishtinë, 2 shkurt 1998, 14.

<sup>19</sup> Po më 28 qershor të vitit 1985 filloi punimet Komisioni për hartimin e Memorandumit, SANU. Çdo gjë tjetër mund të ishte, përveçse koincidencë kur pikërisht më 28 qershor 2001, Slobodan Milošević u ekstradua për në Hagë. B92. 2012. *What is Vidovdan, and why is it so important to Serbs?* (Beograd, 28, June 2012) (shikuar më 15.08.2021).

[https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav\\_id=81009](https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav_id=81009).

\* Duke veçuar heroizmin e Milosh Kopiliqit (Miloš Obilić).

\*\* Humbja e Kosovës.

\*\*\* Kthimi i Kosovës.

<sup>20</sup> Sima Ćirković, *The Serbs* (London: Blackwell, 2004), 85.

<sup>21</sup> Höpken, "Legjenda", 6.

ardhur një porosi nga lajmëtari i Zotit për të cilën legjenda thotë se princi u sfidua të zgjedhë midis mbretërisë së qiellit dhe tokës. Më tej, thuhet se pas një meditimi të thellë ai zgjodhi mbretërinë e qiellit (shenjtërimin), duke dhënë jetën në mbrojtje të atdheut.<sup>22</sup> Në këtë kontekst legjenda serbe të kujton një fjalim thuajse profetik, të Lazarit në prag të betejës, pasi princi serb kishte thirrur të gjithë njerëzit e tij duke iu drejtuar me një predikim: qëllimi i të cilit thuhet të jetë motivimi për luftë kundër osmanëve. Derisa po fliste për idealet, trimërinë e vdekjen thotë:

“Së pari dua t’ju them, shokë, se ju duhet të qëndroni këtu. Ky është vendi juaj, këto janë shtëpitë tuaja..., më mirë është vdekja në përpjekje heroike sesa jeta në turp..., drejtësia është në anën tonë, sepse armiku ka hyrë në vendin tonë dhe ka pushtuar shumë vende; ne kemi nevojë, për njerëz të guximshëm madje edhe për frikacakët më të mëdhenj..., më mirë të takohemi me vdekjen me shpatë sesa t’i kthejmë shpinën armiqve tanë..., le të mos kursejmë jetën tonë, për të qenë një shembull i gjallë për të tjerët më pas.”<sup>23</sup>

Me vdekjen e Lazarit serbëve filloi t’u thuhej: "Ne do të bëjmë një shtet përsëri". Kjo do të thotë se ne jemi zgjedhur për mbretërinë e parajsës, ne nuk mund të humbasim, dhe kjo është ajo që njerëzit do të thonë kur të flasin për serbët si “një popull qiellor”. Në këtë mënyrë serbët e identifikojnë veten me hebrejtë. Si viktimë, po, por edhe me idenë e “tokës së shenjtë”. Mesazhi është: “Ne jemi viktimë, por do të mbijetojmë.”<sup>24</sup> Përmes Betejës së Kosovës synohej të aludohej për trimërinë e popullit serb, të cilën nacionalistët serbë edhe në ditët e sotme e hiperbolizojnë si një tipar kolektiv të karakterit të serbëve: gatishmërinë për të luftuar edhe atëherë kur dihet se humbin [siç ishte rasti me NATO-n më 1999 - B.Q.]. Kjo dhunti paraqet sërish një mësim për të tashmen si një “amanet i Betejës së Kosovës”.<sup>25</sup> Prandaj, sot e kësaj dite, serbët e shohin Kosovën si zemër origjinale të popullit serb, e cila në asnjë mënyrë nuk mund t’i dorëzohet shumicës së tij shqiptare, shkruan A. D.

<sup>22</sup> Stojan Novakovic, *Kosovo Srpske Narodne Pesme O Boju Na Kosovu (1906)*, Digitized by the Internet Archive in with funding from University of Toronto (Canada: Pontifical Institute of Mediaeval Studies, 2011), 43.

<sup>23</sup> Mavro Orbini, *Kraljevstvo Slavena*, Edited by Franjo Šanjek (Zagreb: Golden Marketing 1999), 377-79; Jelka Redep Jelka, "The Legend of Kosovo", *Oral Tradition*, 6/2 3 (Sarajevë: 1991), 55-6.

<sup>24</sup> Judah, *The Serbs*, 36.

<sup>25</sup> Höpken, "Legjenda", 6.

Smith.<sup>26</sup> Që nga ajo kohë heroika kosovare u ruajt brez pas brezi; u bë pjesë e qenies së popullit serb; u bë vlerë e tij madhështore; amanet për brezat e ardhshëm, të popullit serb, - u thoshte të pranishmëve Desimir Jevtić gjatë një akademie solemne me rastin e festimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës.<sup>27</sup> Më 28 qershor 1871 në Prizren ishte themeluar çerdhja e Vidovdanit. Unioni studentor "Rastko", i quajtur sipas emrit laik Shën Sava, përkujtoi Vidovdanin për të promovuar propagandën kombëtare. Shpërthimi i nacionalizmit serb në fillim të shek. XX e gjallëroi edhe më shumë kultin e betejës. "Hakmarrja e Kosovës" u bë slogani i ditës.<sup>28</sup> Nacionalizmi serb synonte të kishte një lidhje profetike me këtë datë. Më 28 qershor 1914, ndodhi vrasja e trashëgimtarit të Austro-Hungarisë Franz Ferdinand ku pjesë e atentatit ishte Vasa Čubrilović, gjithashtu hartues i planit "Dëbimi i Arnautëve", si dhe pjesëmarrës në takimet e SANU-s më 1986. Po më 28 qershor 1919 ishte nënshkruar Traktati i Versajës, që i jepte fund Luftës së Parë Botërore. Më 28 qershor 1921 Mbreti serb Aleksandër I, shpalli Kushtetutën e re të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.<sup>29</sup>

### Përvjetori kërcënues

Aq shumë ishte folur, shkruar, e mitizuar rreth Fushës së Mëllenjave nga qarqet e ndryshme serbe, sa që edhe kur elementet e furtunës së Luftës së Dytë Botërore kishin dalë në horizont serbët nuk ngurruan ta festonin 550-vjetorin. Asokohe nacionalistët serbë vinin në dukje se festimi i Betejës së Kosovës sikurse edhe më parë, po ndodhte në vitet vendimtare të popullit tonë. Qysh në vitin 1953, qeveria komuniste serbe ngriti një monument të madh për heronjtë e Kosovës në Gazimestan në shenjë vlerësimi të traditës luftarake të popullit serb, e cila u kuptua si shpallja e një revolucionit fitimtar komunist.<sup>30</sup> Serbët nën retë e regjimit të komunizmit, ishin ankuar se data më e rëndësishme për ta

<sup>26</sup> Anthony D. Smith, *Myths and Memories of the Nation* (Oxford: Oxford University Press, 1999), 155.

<sup>27</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 27.06.1989, 1-2.

<sup>28</sup> Đorđević, "The Role of ST Vitus day", 38.

<sup>29</sup> B92, *What is Vidovdan*:

[https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav\\_id=81009](https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav_id=81009).

<sup>30</sup> Ivan Čolović, *The Kosovo Myth* (May 22, 1992s) (shikuar më 05.10.2022).

[https://www.yuhistorija.com/wars\\_91\\_99\\_txt01c6.html](https://www.yuhistorija.com/wars_91_99_txt01c6.html).



ishite fshirë nga ditët e festave.<sup>31</sup> Tani që kishin ndryshuar rrethanat, sidomos pas ardhjes në pushtet të S. Milošević-it, i gjithë kombi serb po e priste ditën e madhe për të kremtuar. E gjithë elita politike ishte përfshirë në organizim. Borisav Jović, në ditarin e tij tregon intensitetin organizativ të elitës politike serbe. Ndër të tjera, ai përmend bisedën me ministrin e Mbrojtjes Veljko Kadijević, i cili kishte tërhequr vërejtjen rreth disa çështjeve: “E para, për politikën tonë në Kosovë në këto momente më e rëndësishmja është t’i kushtohet kujdes 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, në aspektin e sigurisë. Kjo ngjarje do të jetë një provë për vlerësimin e nivelit të sigurisë së vërtetë të organizimit të separatistëve dhe të qëllimeve të tyre, por edhe gatishmërisë sonë. E dyta, para kësaj ngjarjeje të mos merren kurrfarë masash për reduktimin e masave të jashtëzakonshme. Në përputhje me këtë të shtyhet mbledhja e Kryesisë së RSFJ-së”.<sup>32</sup> Që assesi të mos mund të ndikohet nga republikat e tjera. Datën, dhe vendin për festë e kishte përcaktuar historia. Kësaj nisme i kishte paraprirë vendimi i Kishës Ortodokse Serbe për t’i bartur eshtrat e Lazarit nëpër të gjitha "tokat serbe" në Jugosllavi. Arkivoli shoqërohej nga turma të mëdha vajtuesish të veshur në të zeza që qanin në çdo ndalesë.<sup>33</sup> Sikurse edhe në rastet e tjera propaganda nuk mungonte, filluan të shkruheshin artikuj të ndryshëm, për të depërtuar informacioni në çdo cep ku ka serbë.<sup>34</sup> Në të gjithë Serbinë, ethet e Kosovës pushtuan popullsinë. Libraritë serbe mbushën raftet e tyre me libra për Kosovën, ndërsa artistët muzikorë ia kushtuan veprat e tyre Kosovës. Aq shumë kujdeseshin për detajet saqë një parfum i ri, "Miss 1389", ngjalli imazhe të betejës.<sup>35</sup> U përfshinë organizata punonjëse anembanë Serbisë. Muaji qershor u bë muaji i të kremtes festive. U krijua logoja festive, në treg filluan të dalin prodhime e suvenire të ndryshme që lidheshin me personazhet e betejës, si Knjaz Lazari dhe Milosh Kopiliqi.<sup>36</sup> Synohej t’u tregohej të gjithëve se Kosova është ende një vend pelegrinazhi për

<sup>31</sup> Dorđević, “The Role of ST Vitusr day”, 39.

<sup>32</sup> “Pjesë nga Ditari i Borisav Jovićit ditët e fundit të RSFJ”, *Bujku*, Prishtinë, 25 nëntor 1995, 4.

<sup>33</sup> Mikel Ndreca, *87 Vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)* (Prishtinë: Rentabil 2001), 263.

<sup>34</sup> Zirojević, “Kosovo”, 206.

<sup>35</sup> David B. Macdonald, *Balkan holocausts? Serbian and Croatian victim-centred propaganda and the war in Yugoslavia* (Manchester & New York: Manchester University Press, 2002), 72.

<sup>36</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 19.06.1989, 8.

serbët, ashtu si baladat epike të Kosovës të heroit të tyre, Marko, vazhdojnë të kenë një vend të veçantë në zemrat serbe.<sup>37</sup> Televizioni i Beogradit krijoi filmin "Beteja e Kosovës", i cili brenda një periudhe të shkurtër do të shfaqej në qendrat kryesore të Serbisë, në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë etj. Ndërsa për publikun e gjerë u kujdesën që më 26 qershor, dy ditë para përvjetorit, ta shfaqin në ekranet e vogla. Muzeu Historik, Etnografik, Popullor, galeritë e Beogradit secili veç e veç kishin marrë përsipër organizimin e ekspozitave përkatëse me temë "Beteja e Kosovës".<sup>38</sup> U pasuan tubime popullore në Bosnjë dhe në Kroaci<sup>39</sup> [në zona të banuara me serbë - B.Q.]. Simpoziumet e studiuesve në Beograd dhe në vende të tjera trajtonin rëndësinë historike të Betejës së vitit 1389.<sup>40</sup> Organizatorët tashmë kishin bërë gati gjithçka; për t'i dhënë karakter sa më të fortë nacionalizmit kishin sjellë eshtrat e knjaz Lazarit, ku qytetarët për një javë rresht kishin mundësinë të bënin nderime para eshtrave të ekspozuara para kishës së Graçanicës. Në aspektin teknik gjithçka ishte planifikuar në detaje: sigurimi i tribunës, hapësirë e mjaftueshme për parkim; instruksione të qarta sinjalizuese; sigurim transporti; sigurimin e furnizimeve me pije dhe gjëra ushqimore; lokalet dhe shërbimet hoteliere do të punonin me orare të zgjatura gjatë dy ditëve festive. Për shëndetin e pjesëmarrësve, do të kujdeseshin mbi 40 ekipe mjekësore me dy spitale improvizuese dhe dyzet automjete të ndihmës së shpejtë, përfshi këtu edhe dy helikopterë. Organizatorët shprehnin gatishmërinë për pritjen e rreth një milion qytetarëve.<sup>41</sup> Monumenti qendror ishte vendosur mbi platformën e rrethuar nga kulla në formë plumbi, ku ishin gdhendur numrat "1389-1989".<sup>42</sup> L. Cohen e përshkruan

<sup>37</sup> Smith, *Myths and Memories*, 155.

<sup>38</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 20.06.1989, 8.

<sup>39</sup> Sulmi tjetër i madh i makinës së Milošević-it erdhi vetëm pak ditë pas përvjetorit të Betejës së Kosovës. Nën presionin e Serbisë, autoritetet kroate organizuan dhe financuan një kremtim shtesë të përvjetorit në Knin, më 8 dhe 9 korrik. I mbajtur para rreth tridhjetë mijë serbëve nga rajoni i Kninit dhe nga Serbia e Bosnja, u shndërrua shpejt në një tubim nacionalist. Turma mbante pankarta me slogane që lavdëronin Milošević-in, duke premtuar mbështetje për të gjitha përpjekjet e ardhshme të luftës dhe duke paralajmëruar qeverinë kroate, "Ushtria është plot me gjeneralë dhe ata janë të gjithë serbë!". Josip Glaurdić, *The Hour of Europe Western Powers and the Breakup of Yugoslavia*. (New Haven & London: Yale University Press, 2011), 51.

<sup>40</sup> Đorđević, "The Role of ST Vitusr day", 39.

<sup>41</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 28.06.1989, 1-5.

<sup>42</sup> Kaplan, *Fantazma e Ballkanit*, 77.

si një nga ngjarjet më dramatike dhe të mirëpërgatitura sipas një skenografie të kujdesshme në historinë moderne të Serbisë. Ky manifestim ishte një nga më të rëndësishmit për faktin se pakënaqësia ndaj situatës politike që mbretëronte në atë kohë i dha shtetit serb, më konkretisht Milošević-it, mundësinë për ta ringjallur mitin parësor kombëtar.<sup>43</sup>

Dita e festimit filloi herët. Në orën 7 të mëngjesit u zhvillua një liturgji në manastirin e Graçanicës, për të vazhduar festën në vendin e fushëbetejës historike. Publiku serb dukej i ekzaltuar, thuajse në kufijtë e një histerie masive.<sup>44</sup> Serbët që kur vërshuan nëpër rrugë kishin filluar me një humor agresiv e sfidues. Të dyndur nga e gjithë bota, kishin kaluar orë të tëra në trafik, duke duruar një mori sprovash vetëm e vetëm për t'iu përgjigjur ftesës ceremoniale të të gjithë serbëve nën udhëheqjen e Slobodan Milošević-it. Festimi në Gazimestan, ndryshonte nga mitingjet antiburokratike, ku merrnin pjesë punëtorë me pamje të lodhur, që vinin nga fabrikat. Mirëpo, ky ishte një rast i rëndësishëm, - nënvizonin nacionalistët serbë. Në këtë kontekst nuk ka dilemë se qeveria serbe organizoi, u kujdes e i dërgoi turmat në Kosovë. Por, siç shkruajnë Silber & Little, njerëzit në tubim ishin krenarë që ishin pjesë e kësaj shprehjeje të fuqishme të unitetit serb.<sup>45</sup> Kjo, për faktin se shumica e serbëve e shihnin Milošević-in më shumë sesa kreun e shtetit: ai shihej si fituesi i udhëheqjes së partisë së burokratizuar në seancën e tetë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Serbe; si udhëheqësi i padiskutueshëm i revolucionit antiburokratik; fitues në konsolidimin e pushtetit shtetëror dhe centralizimin e Serbisë me amendamentet kushtetuese të miratuara në mars të vitit 1989. Ndërsa në tubimin e Gazimestanit ai shihej si kandidat për heroin e ri të Kosovës.<sup>46</sup> Ndërkohë që turma po priste ardhjen e liderit të tyre Milošević-i mbërriti me helikopter, drejt nga qielli si një Mesi (shpëtimtar).<sup>47</sup> Në perceptimin serb “gjithçka dukej perfekte”. Në rreshtin

<sup>43</sup> Lenard J. Cohen, *Milosheviç, Misteri i Pushtetit* (Tiranë: AISS, 2010), 13.

<sup>44</sup> Karl Kaser, Joel M. Halpern, "Historical Myth and the Invention of Political Folklore in Contemporary Serbia." *Anthropology of East Europe Review*, 16 no 1 (Spring 1998), 89-107 (shikuar më 22.05.2022).

<https://scholarworks.iu.edu/journals/index.php/aeer/article/view/689>.

<sup>45</sup> Sibling & Little, *Yugoslavia*, 72.

<sup>46</sup> *Vreme*, Beograd, 26.06.1989 (shikuar më 16.05.2022).

<https://www.vreme.com/vreme/dogadjanje-vodje-u-odsudnom-trenutku/>.

<sup>47</sup> Azem Vllasi, *Kosova: Fillim që nuk harrohet* (Prishtinë: KOHA, 2017), 566.

e parë vendi ishte rezervuar për elitën politike, në të cilin qëndronin kreu shtetëror dhe politik serb si dhe nga kreu i Jugosllavisë, ku përveç kryepersonazhit Slobodan Milošević merrnin pjesë edhe Janez Drnovšek, kryetar i Kryesisë së RFSJ-së; Milan Pančevski, kryetar i Kryesisë së KQ të LKJ-së; Ante Marković, kryetar i KE të Kuvendit të RFSJ-së; Veljko Kadijević, sekretar federativ i mbrojtjes popullore.<sup>48</sup> Ndërsa në perceptimin e jashtëm gjërat dukeshin më të zbehta [tendencioze - B.Q.].<sup>49</sup> Megjithëse Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë kishte organizuar një tren të posaçëm për transportimin e perëndimorëve,<sup>50</sup> festa u bojkotua nga të gjithë diplomatët perëndimorë. Ata me të drejtë refuzuan ta legjitimonin provokimin politik të liderit serb.<sup>51</sup> Sidoqoftë, ajo që dihet është se pjesëmarrja ishte masive. Agjencia e lajmeve amerikane Associated Press vlerësoi se në tubim kishin marrë pjesë rreth 300 mijë njerëz.<sup>52</sup> Në anën tjetër, propaganda serbe shkruante se në tubim merrnin pjesë nga 1 deri në 1.5 milionë serbë që vinin nga e gjithë federata dhe një numër i konsiderueshëm nga diaspora serbe.<sup>53</sup> Në këtë manifestim nuk kishte shqiptarë, edhe pse Kosova ishte e banuar me shumicë shqiptare; serbët si organizatorë nuk e parapanë pjesëmarrjen e tyre; edhe pse si vendës shqiptarët ishin ndër popujt pjesëmarrës të betejës që kishin luftuar kundër osmanëve. Ky manifestim ishte një manifestim i pastër serb, nuk përfaqësonte elementin e aleancës ballkanike çka ishte e vërteta. Përkundrazi ballkanasit u përjashtuan, e më së shumti prej tyre shqiptarët ku ngjarja kishte ndodhur, dhe po festohej në vendin e tyre amnor. Mirëpo, kjo politikë tashmë ishte e njohur për shqiptarët. Serbët kishin vendosur që problemin e Kosovës ta zgjidhnin

<sup>48</sup> Ç'është e vërteta kishte të pranishëm edhe nga një pjesë e parisë lojaliste të Kosovës, Riza Sapunxhiu që përfaqësonte Kryesinë e RFSJ-së, Jusuf Zejnullahu, si anëtar i dy kryesive dhe Rrahman Morina si kryetar i Kryesisë së Kosovës, të cilët si funksionarë të institucioneve ishin të detyruar të merrnin pjesë. *Rilindja*, Prishtinë, 29.06.1989, 1-6.

<sup>49</sup> Duke komentuar pjesëmarrjen e tij në Gazimestan, ambasadori i Turqisë në Beograd ndër të tjera kishte theksuar: "Nëse dikush ka arsye të festojë atë betejë, ata jemi ne turqit, që fituam atë betejë". Vllasi, *Kosova*, 566.

<sup>50</sup> Adam LeBor, *Milosevic: A Biography* (London: Yale University Press, 2004), 123.

<sup>51</sup> Meier, *Fundi i Jugosllavisë*, 173.

<sup>52</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 29.06.1989, 1-6.

<sup>53</sup> Mertus, *Kosovo*, 17; Ndreca, *87 Vjet terror*, 262.

dhunshëm dhe pa i konsideruar fare ata si popull që përbënin shumicën.<sup>54</sup> Ceremonia hyrëse filloi me një atmosferë kënge e festimi, ku e gjithë vëmendja ishte te Milošević-i. Pelegrinistët ishin mbushur me fotografi, në njërën dorë mbanin fotografinë e Milošević-it e në dorën tjetër atë të princ Lazarit.<sup>55</sup> Krahasimi patjetër që nuk ishte rastësi. Kjo vërehej edhe nga parullat që mbanin; pjesëmarrësit në mënyrë të vazhdueshme brohorisnin: "Të duam Slobodan", "Kosova është Serbi", "Zoti i ruajt Serbët".<sup>56</sup> Me gjithë deklaratimet boshe të lidershit serb, se po e ndiqnin rrugën e Titos dhe se "në Kosovë po përcaktohet fati i Jugosllavisë dhe fati i socializmit",<sup>57</sup> faktet dëshmonin të kundërtën, kudo shiheshin pankartat e dirigjuara. Tek e gjithë ajo turmë nuk u gjend as edhe një foto e Titos.<sup>58</sup> Përkundrazi, nacionalizmi po shpërfaqej sikur edhe më parë. Në vazhdimësi dëgjohej kënga patriotike "Ko to kaže, ko to laže, Srbija je mala" (Kush ka thënë, ka gënjer, se Serbia është e vogël). Thënë ndryshe, e gjithë lavdia i dedikohej popullit serb: "Evropë le të bie ndërmend se në Kosovë ju mbrojtëm edhe juve".<sup>59</sup> Përballë turmës së elektrizuar Milošević-i doli në skenë i trimëruar. Me një fjalim të gjatë e të detajuar, nga skena 18 metra e lartë, prezantoi vizionin e një Serbie të "rilindur, unike, të fortë dhe dinjitoze" duke konstatuar se: "Vetëm tani pas gjashtëqind vjetësh, padrejtësitë që i janë bërë popullit serb në të kaluarën tani nën udhëheqjen e tij kanë filluar të korrigojohen". Për shkak të rrethanave sociale, ky jubile i madh i Betejës së Kosovës festohet në vitin në të cilin "Serbia pas shumë dekadash e rifitoi integritetin e saj shtetëror, kombëtar dhe shpirtëror, prandaj sot nuk e kemi të vështirë t'i përgjigjemi pyetjes së vjetër: çfarë do të bëjmë me të?"<sup>60</sup> Në fjalim kishte momente kur lideri serb tentonte të dukej liberal i butë dhe projugosllav,

<sup>54</sup> Shkëlzen Maliqi, *Nyja e Kosovës: as Vllasi as Millosheviqi* (Lublanë: Knjižna zbirka KRT, 1998), 291.

<sup>55</sup> LeBor, *Milosevic*, 124.

<sup>56</sup> *Rilindja*, Prishtinë, 29.06.1989, 1-6.

<sup>57</sup> Marina Blagojević, "The Migration of Serbs from Kosovo during the 1970s and 1980s: Trauma and/or Catharsis", in *The Road to War in Serbia Trauma and Catharsis*, edited by Nebojša Popov (Budapest: Central European University Press, 2000), 214, 212-246.

<sup>58</sup> Cohen, *Miloshević*, 14.

<sup>59</sup> Gazimestanu, "Slobodana Miloševića na Gazimestanu", *YouTube*. (Jun 28. 1989) (shikuar më 23.05.2022). <https://www.youtube.com/watch?v=vdU6ngDhrAA>.

<sup>60</sup> *Vreme*, broj 454, Beograd, 18 Septembar 1999 (shikuar më 28.05.2022). [https://www.vreme.co.rs/arhiva\\_html/454/10.html](https://www.vreme.co.rs/arhiva_html/454/10.html).

duke nënvizuar se "Jugosllavia është bashkësi shumëkombëshe dhe ajo mund të ekzistojë vetëm me kushtet e barazisë së plotë të të gjitha kombeve që jetojnë në të",<sup>61</sup> mirëpo pakkush, nga auditori joserb i besuan, ngaqë barazia për Milošević-in nënkuptonte dominim të serbëve e nënshtrimin e popujve të tjerë jugosllavë. Edhe më pak i besueshëm dukej kur nënvizonte se, "askund në truallin e atdheut tonë nuk ka rëndësi më të madhe se fjalët që i kushtohen bashkimit, solidaritetit, bashkëpunimit ndërmjet njerëzve, sa ka këtu në Fushë Kosovë i cili është simbol i përçarjes dhe i tradhtisë". Me këtë qëndrim lideri suprem synonte të argumentonte se, nëse nuk jemi të bashkuar sipas rregullave dhe diktatit të tij do t'i vuajmë pasojat ashtu siç i ka vuajtur populli serb për pesëqind vjet. Duke rikujtuar madhështinë e popullit serb, Milošević-i theksoi se: "Trimëria kosovare nuk na lejon të harrojmë se njëherë kemi qenë ushtri e madhe e guximshme dhe krenare..." aq e madhe sa para gjashtë shekujsh Serbia këtu në Fushë-Kosovë mbrojti me trimëri vetveten, por mbrojti edhe Evropën". Prandaj sot, gjashtë shekuj më vonë, sërish jemi në betejë dhe para betejave. Këto nuk janë beteja të armatosura, edhe pse të tilla nuk përjashtohen,<sup>62</sup> qëndrim të cilën turma e duartrokiti në mënyrë frenetike.<sup>63</sup> Për Misha Glenn-in ky ishte një mesazh i qartë i Milošević-it, për sllovenët, kroatët, shqiptarët dhe maqedonasit se: "me çfarë lehtësie ai mund të mobilizojë mbi një milion serbë".<sup>64</sup> Ndërsa sipas pikëpamjes së Milan Milošević-it, lideri serb nuk i kishte në mendje luftërat e mëvonshme në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Ai e kishte fjalën për vetë Kosovën, për të promovuar mitin e Kosovës si djep i kulturës mesjetare serbe dhe, si rrjedhim, gurëthemel i identitetit kombëtar të çdo serbi.<sup>65</sup> Sido që të jetë, ajo që dihet është se që nga fillimi e deri në fund fjalimi i tij nuk dha asnjë shpresë për pajtim me

<sup>61</sup> Deklaratë tipike mashtruese, ngaqë për shqiptarët dhe jo vetëm ky parim nuk vlente edhe pse ishin shumicë absolute në Kosovë; vetëm disa muaj më parë nën masa të dhunshme u ishte marrë autonomia pa vullnetin e tyre. *Rilindja*, Prishtinë, 29.06.1989, 1-6.

<sup>62</sup> *Po aty*.

<sup>63</sup> Gazimestanu, "Slobodana Miloševića na Gazimestanu", *YouTube*. (Jun 28. 1989) (shikuar më 23.05.2022). <https://www.youtube.com/watch?v=vdU6ngDhrAA>.

<sup>64</sup> Misha Glenny, *Rënia e Jugosllavisë*, përkthyer nga Ismet Zagonjori (Shkodër: Rozafa, 1993), 36.

<sup>65</sup> Milan Milošević, "The MediaWars: 1987-1997", in *Burn This House: The Making and Unmaking of Yugoslavia*, edited by Jasminka Udovicki & James Ridgeway (London: Duke University, 2000), 111.

shqiptarët, dhe jo vetëm.<sup>66</sup> Prandaj, çdo fjalë e thënë në Gazimestan sigurisht që nuk ka qenë e zgjedhur rastësisht, ato dolën të ishin një lloj lajmërimi i tragjedisë jugosllave.<sup>67</sup> Ngaqë ai paralajmëroi se do të vazhdonte politikën e vet, madje edhe nëse ishte nevoja do të hapte beteja të reja.<sup>68</sup> Rreth kësaj pikëpamjeje Milošević-i qysh nga fundi i viteve '80, i ishte drejtuar inteligjencies serbe për ndihmë që të përpunonte botëkuptimin ideologjik të regjimit të ri pastitist.<sup>69</sup> Fatkeqësisht elita serbe e kishte përqaftuar këtë politikë, e cila prej kohësh kishte kontribuar te publiku i gjerë në Serbi të formonte mendimin se “nyja e Kosovës” dhe nyjat e tjera që kishin të bënin me serbët duhej të pritëshin, në vend që të përpiqeshin të gjenin zgjidhje.<sup>70</sup> Këtë e dëshmon fakti se mbështetësit më të zjarrtë të Milošević-it i përkisnin grupit të akademikëve që kishin hartuar draftin e Memorandumit të vitit 1986, në të cilin shprehimisht thuhej: “Në qoftë se kombet e tjera të Jugosllavisë nuk e pranoin zgjidhjen serbe të riintegritimit të Jugosllavisë, serbëve do t'u duhej të merrnin parasysh alternativa të tjera duke kërcënuar me luftë”.<sup>71</sup> Sipas ish-politikanit kosovar, Mahmut Bakalli, kjo filozofi politike ishte e gabueshme jo vetëm pse ishte serbomadhe, ekspansioniste, antishqiptare, por si “model” ishte i gabueshëm edhe për vetë serbët, sepse si zgjidhje ofronte vetëm luftën si gjendje natyrore të popullit, ngaqë vetë luftën e merrte si faktorin kryesor të ekzistencës së popullit dhe ripërtëritjes së tij.<sup>72</sup> Fillimisht, orientimi politik i deklaruar i regjimit serb mishëronte pikërisht aspektet që kërkonte dokumenti i tyre, që ishte hedhje poshtë e Kushtetutës së vitit 1974 e cila nënkuptonte: kthimin e krahinave nën kontrollin e Serbisë dhe qëndrimin e vendosur

<sup>66</sup> Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve. Një histori e Kosovës*, shqipëruar nga Xhevdet Shehu (Tiranë: Toena, 2004), 291.

<sup>67</sup> Aleksandar Nenadović, "Politica in the Storm of Nationalism", In *The Road to War in Serbia: Trauma and Catharsis*, edited by Nebojša Popov (Budapest: Central European University Press, 2000), 557.

<sup>68</sup> Vllasi, *Kosova*, 566.

<sup>69</sup> Cohen, *Milosheviç*, 28.

<sup>70</sup> Čolović, *The Kosovo Myth*. (May 22. 1992s) (shikuar më 05.10.2022).

[https://www.yuhistorija.com/wars\\_91\\_99\\_txt01c6.html](https://www.yuhistorija.com/wars_91_99_txt01c6.html).

<sup>71</sup> Peter Radan, *The Break-up of Yugoslavia and International Law* (London: Routledge, 2002), 154.

<sup>72</sup> Intervistë me Mahmut Bakallin, “Fitorja do të na takojë”, në *Fjala* (Prishtinë: tetor 1991), 8-9.

kundër "separatizmit dhe terrorizmit" shqiptar.<sup>73</sup> Në këtë kontekst aq shumë i është lejuar nacionalizmit serb që ta vajtojë Kosovën, sa që e kanë quajtur si "trup dhe tragjedi kombëtare", duke nxitur urrejtje shekullore ndaj shqiptarëve si zaptues të tokës së tyre.<sup>74</sup> Këtë fakt e ilustron më së miri vlerësimi i akademikut serb Matija Bečković, i cili, në vigjilje të përvjetorit, deklaronte: "Në gjashtëqind vjetorin e Betejës së Kosovës, duhet të shpallim se Kosova është serbe, dhe se ky fakt nuk varet as nga lindja shqiptare dhe as nga vdekshmëria serbe. Ka aq shumë gjak serb, dhe aq shumë relikte të shenjta në Kosovë, sa që Kosova do të mbetet tokë serbe, edhe sikur të mos mbetet asnjë serb atje".<sup>75</sup> Ishte pikërisht kjo ngjarje, e cila u dha fund shpresave të atyre që gënjenin veten me ëndrrën se "fitorja e Kosovës do t'i ngopte njëherë e mirë orekset serbe".<sup>76</sup> Gazimestani ishte një lëvizje që hapi një lojë të ftohtë numrash, në të cilën lojtarët peshonin se sa do të ishte numri i njerëzve që mund të humbnin, për të ruajtur pushtetin e tyre politik.<sup>77</sup> Po ashtu, Gazimestani u bë jo vetëm ngjarja përcaktuese e vendit përgjatë gjithë atij viti, por edhe një pikë kthese e vërtetë në zhvillimin e krizës. Përpjekjet e Milošević-it për të zgjeruar pushtetin e tij drejt perëndimit (Sllovenisë dhe Kroacisë) e çuan të gjithë sistemin qeverisës drejt kolapsit, duke shkatërruar çdo mundësi për një konsensus të ri në lidhje me të ardhmen e përbashkët jugosllave.<sup>78</sup>

## Përfundime

Qysh nga ardhja e tij në pushtet në vitin 1987, Slobodan Milošević, arriti një fuqizim të shpejtë duke mbjellë panik dhe frikë në mbarë Jugosllavinë. Në vazhdimësi serbët ishin ankuar në lënien e tyre pas dore

<sup>73</sup> Jasna Dragovic-Soso, *Saviours of the Nation: Serbia's intellectual opposition and the revival of nationalism*. (United Kingdom: Me Gill-Queen's University Press, 2002), 220.

<sup>74</sup> Maliqi, *Nyja e Kosovës*, 292.

<sup>75</sup> Florian Bieber, "Nationalist Mobilization and Stories - The Kosovo myth from 600th anniversary to the present", *Rethinking History* 6:1 (2002): 95-110 (shikuar më 25.10.2022).

[https://www.researchgate.net/publication/248990914\\_Nationalist\\_Mobilization\\_and\\_Stories\\_of\\_Serb\\_Suffering](https://www.researchgate.net/publication/248990914_Nationalist_Mobilization_and_Stories_of_Serb_Suffering).

<sup>76</sup> Meier, *Fundi i Jugosllavisë*, 146.

<sup>77</sup> Glenny, *Rënia e Jugosllavisë*, 36.

<sup>78</sup> Glaudić, *The Hour of Europe*, 46.



gjatë periudhës titiste me parullën “Serbia e dobët – Jugosllavia e fortë”. Me ardhjen e tij në pushtet, ai po synonte ta ndryshonte këtë rregull.

Suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës me tanke dhe forca policore, e terror ushtarak, ishte saktësisht pjesë e kësaj ideologjie politike. Gëzimi që ky ndryshim po fillonte, kishte bërë që serbët dhe udhëheqja e tyre të përfshiheshin në një valë të vërtetë ngazëllimi. Kudo në institucione më në fund ishte dëgjuar fraza: “është kthyer në vend drejtësia dhe barazia”.

Aq thellë ishte futur nacionalizmi në qarqet serbe të udhëhequra nga lideri Slobodan Milošević, sa që barabarësinë dhe drejtësinë i konsideronin si të drejta absolute që u takonin ekskluzivisht vetëm serbëve, ndërsa popujve të tjerë që ishin pjesë e barabartë e një bashkësie të quajtur Jugosllavi u mbetej të nënshtroheshin, ose do të përballeshin me Serbinë.

Këto ide lideri serb i shpërfaqti në mënyrë krejtësisht transparente para një turme me qindra mijëra serbë që kishin ardhur nga të gjitha trevat, përfshi këtu edhe diasporën serbe, për të festuar përvjetorin e gjashtëqind të Betejës së Kosovës. I ngazëllyer, nga masa e cila e kishte pritur si “Mesinë”, Presidenti serb S. Milošević, iu drejtua turmës: “Sot gjashtë shekuj më vonë sërish jemi në betejë dhe para betejave. Këto nuk janë beteja të armatosura, edhe pse të tilla nuk përjashtohen”.

Ngjarjet që ndodhën më pas vërtetuan faktin se: sllovenët, kroatët, boshnjakët dhe së fundmi shqiptarët, në momentin që nuk pranuan nënshttrimin serb u përballën me luftëra të njëpasnjëshme. Pasojat e këtyre luftërave tashmë janë të njohura, sikurse dihet shkaktari kryesor dhe i vetëm, politika nacionaliste serbe me në krye liderin e saj Slobodan Milošević.

## **Bibliografi:**

### **Literaturë historiografike:**

Anzulović, Branimir. *Serbia hyjnore nga Miti te gjenocidi (Heavenly Serbia: From Myth to Genocide)*. Prishtinë: KOHA, 2017.

Biserko, Sonja. *Yugoslavia's Implosion: The Fatal Attraction of Serbian Nationalism*. Beograd: The Norwegian Helsinki Committee, 2012.

Blagojević, Marina. “The Migration of Serbs from Kosovo during the 1970s and 1980s: Trauma and/or Catharsis”. Në *The Road to War in*

- Serbia Trauma and Catharsis*. Redaktuar nga Nebojša Popov. Budapest: Central European University Press, 2000.
- Ćirković, Sima. *The Serbs*. London: Blackwell, 2004.
- Clark, Howard. *Civil Resistance in Kosovo*. Londo: Pluto Press, 2000.
- Cohen, Lenard J. *Miloseviç, Misteri i Pushtetit*. Përkthyer nga Virgjlil Muçi. Tiranë: AISS, 2010.
- Čubrilović, Vasa. *Shpërngulja e shqiptarëve (Iseljavanje Arnauta)*. USA: 1982.
- Đorđević, Dimitrije. "The Role of ST. Viturs Day in Modern Serbian". *North American Society for Serbian Studies*, vol. 5, no. 3, Beograd: 1990.
- Dragovic-Soso, Jasna. *Saviours of the Nation: Serbia's intellectual opposition and the revival of nationalism*. United Kingdom: Me Gill-Queen's University Press, 2002.
- Gagnon, Valere. "Shqiptarët nuk kanë asnjë interes të jenë me Serbinë". *Kombi*, Prishtinë, 2 shkurt 1998.
- Glaurdić, Josip. *The Hour of Europe Western Powers and the Breakup of Yugoslavia*. New Haven & London: Yale University Press, 2011.
- Glenny, Misha. *Rënia e Jugosllavisë (The fall of Yugoslavia)*. Përkthyer nga Ismet Zagonjori. Shkodër: Rozafa. 1993.
- Hall, Brian. "Njerëzit që s'kanë nga t'ia mbajnë (People who can not afford it)". Në *Zëri - E përjavshme politike* (Weekly Political Magazine), Prishtinë, 31 dhjetor 1994.
- Höpken, Wolfgang. "Legjenda e llahtarshme e Fushë-Kosovës". *Koha Ditore*, 16 mars 1998.
- Horvat, Branko. *Kosovsko Pitanje*. vëll. I (Drugo dopunjeno izdanje). Zagreb: Globus, 1989.
- "Intervistë me Mahmut Bakallin. 'Fitorja do të na takojë'". Në *Fjala*. Prishtinë: Tetor 1991.
- Judah, Tim. *The Serbs: History, Myth, and the Destruction of Yugoslavia*, vëll. I. Second Edition. London: Yale University Press, 2000.
- Judah., Tim. *Kosova - Luftë dhe hakmarrje (Kosovo War and Revange)*. Përkthyer nga Majlinda Raxhimi - Nishku. Prishtinë: Koha, 2002.
- Kaplan, Robert D. *Fantazma e Ballkanit një udhëtim nëpër histori* (Balkan Ghosts: A Journey Through History). Përkthyer nga Çapajev Zëre. Tiranë: Plejad, 2011.
- Laura Silber & Allan Little. *Yugoslavia Death of a Nation*. Boston : Penguin Books, 1997.
- LeBor, Adam. *Milosevic: A Biography*. London: Yale University Press, 2004.
- Macdonald, David Bruce. *Balkan holocausts? Serbian and Croatian victim-centred propaganda and the war in Yugoslavia*. Manchester & New York: Manchester University Press, 2002.

- Malcolm, Neol. *Kosova një histori e shkurtër (Kosovo: A Short History)*, vëll. II. Përkthyer nga Abdullah Karjagdiu. Prishtinë - Tiranë: Koha - Shtëpia e Librit, 2001.
- Maliqi, Shkëlzen. *Nyja e Kosovës: As Vllasi as Millosheviqi*. Lubljanë: Knjižna zbirka KRT, 1998.
- Meier, Viktor. *Fundi i Jugosllavisë - Goditja në Kosovë (Yugoslavia A History of its Demise)*. Përkthyer nga Elton Lelo. Lubjanë: Lina, 2006.
- Mertus, Julie A. *Kosovo How Myths and Truths Started a War*. Berkeley / Los Angeles / London: University of California Press, 1999.
- Milošević, Milan. "The Media Wars: 1987-1997". Në *Burn This House: The Making and Unmaking of Yugoslavia*. Redaktuar nga Jasminka Udovički & James Ridgeway. London: Duke University, 2000.
- Ndreca, Mikel. *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999) (87 Years of State Terror and Genocide)*. Prishtinë: Rentabil, 2001.
- Nenadović, Aleksandar. "Politika in the Storm of Nationalism". Në *The Road to War in Serbia: Trauma and Catharsis*. Redaktuar nga Nebojša Popov. Budapest: Central European University Press, 2000.
- Novakovic, Stojan. *Kosovo Srpske Narodne Pesme O Boju Na Kosovu*. Digitized by the Internet Archive in 2011 with funding from University of Toronto. Canada: Pontifical Institute of Mediaeval Studies, 1906.
- Orbini, Mavro. *Kraljevstvo Slavena*. Redaktuar nga Franjo Šanjek. Zagreb: Golden Marketing, 1999.
- Pjesë nga ditari i Borisav Joviç, "Ditët e fundit të RSFJ-së" 1995. Në *Bujku*, Prishtinë, 25 nëntor 1995.
- Radan, Peter. *The Break-up of Yugoslavia and International Law*. London: Routledge, 2002.
- Redep, Jelka. "The Legend of Kosovo". *Oral Tradition*, 6/2 3. Sarajevë: 1991.
- Schmitt, Oliver Jens. *Kosova - Histori e një treve qendrore ballkanike (Kosovo: Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft)*. Përkthyer nga Enver Robelli. Prishtinë: Koha, 2012.
- Smith, Anthony D. *Myths and Memories of the Nation*. Oxford: Oxford University Press, 1999.
- Tomašević, Bato. *Jetë dhe vdekje në Ballkan: një sagë familjare në një shekull konfliktesh (Life and Death in the Balkans: A Family Saga in a Century of Conflict)*. Përkthyer nga Xhevdet Shehu. Tiranë: Onufri, 2009.
- Udovički, Jasminka. "Kosovo". Në *Burne this House The Making and Unmaking of Yugoslavia*. Nga Jasminka Udovički & James Ridgeway. Durham - London: Duke University Press, 2000.

- Vickers, Miranda. *Midis shqiptarëve dhe serbëve. Një histori e Kosovës (Between Serb and Albanian: A History of Kosovo)*. Përkthyer nga Xhevdet Shehu. Tiranë: Toena, 2004.
- Vllasi, Azem. *Kosova: Fillim që nuk harrohet (Kosova: The Unforgettable Beginning)*. Prishtinë: Koha, 2017.
- Woflgan Petritsch & Robert Pichler. *Rruga e gjatë në Luftë-Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare 1989-1999 (The Long Road to War 2002. Kosovo and the International Community 1989-1999)*. Përkthyer nga Genc Llafe. Prishtinë: Koha, 2002.
- Zirojević, Olga. "Kosovo in the Collective Memory". Në *The Road to War in Serbia Trauma and Catharsis*. Redaktuar nga Nebojša Popov. Budapest: Central European University Press, 2000.

### Shtypi:

*Rilindja*, Prishtinë, 1989.

### Artikuj në site online:

- Bieber, Florian. "Nationalist Mobilization and Stories - The Kosovo myth from 600th anniversary to the present". *Rethinking History*, 6:1 (shikuar më 25.10.2022).  
[https://www.researchgate.net/publication/248990914\\_Nationalist\\_Mobilization\\_and\\_Stories\\_of\\_Serb\\_Suffering](https://www.researchgate.net/publication/248990914_Nationalist_Mobilization_and_Stories_of_Serb_Suffering).
- Čolović, Ivan. 1990s. The Kosovo Myth. (May 22. 1992s) (shikuar më 05.10.2022).  
[https://www.yuhistorija.com/wars\\_91\\_99\\_txt01c6.html](https://www.yuhistorija.com/wars_91_99_txt01c6.html).
- Gazimestanu. "Slobodana Miloševića na Gazimestanu". *YouTube*. Jun 28 1989 (shikuar më 23.05.2022).  
<https://www.youtube.com/watch?v=vdU6ngDhrAA>.
- Karl Kaser, Joel M. Halpern. "Historical Myth and the Invention of Political Folklore in Contemporary Serbia". *Anthropology of East Europe Review*, 16, No. 1, Spring 1998 (shikuar më 22.05.2022).  
<https://scholarworks.iu.edu/journals/index.php/aeer/article/view/689>.
- Miladinović, Ivan. *Uzaludne poruke Dobrice Ćosića: Početak procesa osamostaljenja Kosova i Metohije*. 08 06.2020 (shikuar më 28.10.2022).  
<https://www.novosti.rs/vesti/naslovna/drustvo/aktuelno.290.html:869141-Uzaludne-poruke-Dobrice-Cosica-Pocetak-procesa-osamostaljenja-Kosova-i-Metohije>.
- Pavlović, Momčilo. "Kosovo Under Autonomy, 1974-1990". 2006 MM (shikuar më 18.09.2022).

<https://cla.purdue.edu/academic/history/research/si/Team1Reporte.pdf>.

*Vreme* 28 Jun 1989 (shikuar më 16.05.2022).

<https://www.vreme.com/vreme/dogadjanje-vodje-u-odsudnom-trenutku/>.

*Vreme* 15 Septembar» Broj 454. 1989 (shikuar më 28.05.2022).

[https://www.vreme.co.rs/arhiva\\_html/454/10.html](https://www.vreme.co.rs/arhiva_html/454/10.html).

*What is Vidovdan, and why is it so important to Serbs?* B92. 28 June 2012. (shikuar më 08.12.2021).

[https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav\\_id=81009](https://www.b92.net/eng/news/society.php?yyyy=2012&mm=06&dd=28&nav_id=81009).

### BESIM QERIQI

University of Zagreb, Faculty of Croatian Studies, Department of History  
besimqeriqi1@gmail.com

#### *S u m m a r y*

#### GAZIMESTANI - THE BIRTH OF A MYTH

Since his rise to power in 1987, Slobodan Milošević achieved a rapid rise to power by spreading panic and fear throughout Yugoslavia. The Serbs had continuously complained about their neglect during the Titist period with the slogan: "weak Serbia - strong Yugoslavia". With his coming to power, he was aiming to change this rule.

The violent suppression of Kosovo's autonomy with tanks, police forces and military terror, was exactly a part of this political ideology. The joy that this change is beginning had caused the Serbs and their leadership to be involved in a real wave of excitement. Everywhere in institutions, the phrase was finally heard: "justice and equality have returned."

Nationalism was so deeply embedded in the Serbian circles led by the leader Slobodan Milošević that they considered equality and justice as absolute rights that belonged exclusively to the Serbs, while the others who were an equal part of a community called Yugoslavia remained subjugated or had to face Serbia.

The Serbian leader presented these ideas in a completely transparent manner to a crowd of hundreds of thousands of Serbs who had come from all over the world, including the Serbian diaspora, to celebrate the six hundredth anniversary of the Battle of Kosovo. Excited, by the crowd that had welcomed

him as the "Messiah" (savior), Serbian President S. Milošević addressed them saying: "today, six centuries later, we are again in battle and before battles. These are not armed battles, although such are not excluded".

The events that happened afterwards proved the fact: that the Slovenes, the Croats, the Bosniaks and finally the Albanians, when they did not accept submission to Serbia they faced successive wars. The consequences of these wars are known today, as is their main cause - the Serbian nationalist politics led by its leader Slobodan Milošević.